

Në bazë të Programit për aktivitetet në fushën e sportit dhe rinisë në qytetin e Shkupit për vitin 2018 ("Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 01/18 të datës 01 shkurt të vitit 2018), Kryetari i Qytetit të Shkupit e shpall këtë:

**THIRRJE PUBLIKE  
PËR NDARJEN E BURSIVE PËR SPORTISTËT – NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË  
MESME NË TERRITORIN E QYTETIT TË SHKUPIT PËR VITIN 2018**

**I**

Qyteti i Shkupit me qëllim të zmadhimit të motivimit të sportistëve të rinj dhe të talentuar – nxënësit e shkollave të mesme, si dhe për përkrahjen e zhvillimit dhe avancimit të sportit rinorë të nxënësve të shkollave të mesme, implementon dhënien e bursave për sportistë – nxënës të shkollave të mesme, që janë banorë të qytetit të Shkupit dhe të cilët mësojnë në shkollat e mesme në territorin e qytetit të Shkupit.

Në bazë të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Rregulloren e posaçme për dhënien e bursave për sportistët e talentuar – nxënës të shkollave të mesme, banorë të qytetit të Shkupit, që mësojnë në shkollat e mesme në qytetin e Shkupit, do të përzgjidhen dhe do të jepen bursa për 100 sportistë, nxënës dhe nxënës të shkollave të mesme në territorin e qytetit të Shkupit.

Vlerësimi përcaktohet në bazë të:

Të drejtën e fitimit të bursës e kanë nënshtetasit e RM-së, që kanë statusin e nxënësit të rregullt ose të çrregullt në shkollën e mesme në territorin e qytetit të Shkupit, me kushtet vijuese:

Të jenë banorë të qytetit të Shkupit;

Të jenë nxënës në shkollat e mesme në territorin e qytetit të Shkupit;

Të jenë sportistë dhe sportiste aktive, anëtarë të klubeve sportive të regjistruara në territorin e qytetit të Shkupit dhe të jenë të regjistruar në federatat kombëtare sportive në Maqedoni;

Të manifestojnë arritje të larta sportive gjatë vitit të kaluar 2017 dhe 2018, deri në kohën e përfundimit të thirrjes publike.

Këta 100 bursistë, do të fitojnë bursa gjatë tetë muajve të vitit në vijim 2018.

**II**

Aplikantët, përkaj dokumenteve të lartpërmendura, në fletëparaqitjet duhet t'i plotësojnë edhe qëllimet dhe kriteret që janë dhënë si shtojcë të thirrjes publike që është shpallur në ueb faqen e Qytetit të Shkupit. [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk)

**III**

Në procedurën e ndarjes së bursave nga programi për aktivitetet në fushën e sportit dhe rinisë në qytetin e Shkupit gjatë vitit 2018, në procesin e përzgjedhjes do të hyjnë ata aplikantë – nxënës të shkollave të mesme, sportiste dhe sportistë, të cilët në bazë të kriterëve do të sigurojnë së paku 50 nga gjithsej 100 pikë të mundshme.

#### IV

Aplikimi në Thirrjen publike kryhet nëpërmjet deponimit të fletëparaqitjes së posaçme të plotësuar që mund të merret në arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16) ose të merret nga ueb faqja zyrtare e Qytetit të Shkupit [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk)

Aplikuesit, përveç fletëparaqitjes në mënyrë të detyruar duhet t'i deponojnë edhe dokumentet e mëposhtme:

- kopje e letërnjoftimit të prindërve/kujdestar;
- kopje nga certifikata e lindjes e aplikuesit;
- vërtetim nga shkolla e mesme se është nxënës i rregullt ose jashtëm i shkollës në vitin shkollor 2017/2018;
- kopje nga dëftesa e vitit shkollor 2016/2017;
- biografi e shkurtër e aplikuesit ;
- vërtetim nga klubi sportiv se është anëtar i të njëjtit ;
- vërtetim nga federata nacionale amë se është anëtar përfaqësues i gjeneratës së vet;
- vërtetim nga federata nacionale amë për arritjen e rezultateve sportive nga 01.01.2017, deri në përfundimin e shpalljes publike.

#### V

Thirrja publike zgjat **gjithsej 10 ditë**, nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Thirrja publike publikohet më **17.04.2018** dhe zgjat deri më **26.04.2018**.

Fletëparaqitje duhet të deponohen deri te Qyteti i Shkupit, nëpërmjet postës në adresën: Bul. „Ilinden” nr.82, 1000 Shkup, ose në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16), më së voni deri më 26.04.2018 deri në orën 15:00 në ditën e fundit nga përfundimi i Thirrjes publike, me emërtimin: për **“THIRRJE PUBLIKE PËR NDARJEN E BURSIVE PËR SPORTISTËT – NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME NË TERRITORIN E QYTETIT TË SHKUPIT PËR VITIN 2018”**.

Fletëparaqitjet duhet të deponohen në zarf të mbyllur dhe të vulosur, pa shenja të aplikuesit i cili deponon fletëparaqitjen.

Fletëparaqitje të cilat nuk janë deponuar në mënyrën siç kërkohet në tekstin e lartpërmendur, pikërisht përmbajnë të dhëna jo të plota dhe dokumentacion jo të plotë, si dhe ato që nuk do të deponohen në afatin e përcaktuar, nuk do të shqyrtohen.

Informacione plotësuese mund të merrni përmes telefonit në:

02/ 3297-238 dhe 3297-320.

**QYTETI I SHKUPIT**